

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për buxhetin afatmesëm 2026-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të projekt buxhetit 2026 - 2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, në datë **11/07/2025, ora 10:00**.

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura **deri më datë 12 Korrik 2025**, në adresën e emailit:

visi.shera85@gmail.com

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, drejtues/punonjës të administratës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Tatim Taksave, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Pyjeve, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësie Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në Rrogozhinë, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon konsultimin e buxhetit afatmesëm 2026-2028.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit të projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për të qenë sa më afër komunitetit dhe nevojave të tyre.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, BRENDA DATËS 12 Korrik 2025 . visi.shera85@gmail.com Adresa: Këshilli i Bashkisë, kati 2.

Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Si tavanet, alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia dhe investimet.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore. https://bashkiarrogzhine.gov.al/ https://bashkiarrogzhine.gov.al/konsultime-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	19 .06.2025